Gjithashtu në vitet e fundit përmasat e aktivitetit ekonomik ndërmjet dy vendeve janë rritur, por janë ende minimale për dy vende kaq afër njëra-tjetrës. Botime të Institutit Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare kanë analizuar këtë rritje të aktivitetit ekonomik dhe ardhmërinë e tij.<sup>6</sup> Por marrëdhëniet ekonomike janë më të vështira për t’u ndryshuar se sa ato politike, për shkak se në dhjetëvjeçarët e fundit marrëdhëniet ekonomike të Shqipërisë dhe Serbisë janë përqëndruar në drejtime të ndryshme. Serbia është ekonomikisht e lidhur me vendet e Evropës Qendore dhe të ish Jugosllavisë, ndërkohë që Shqipëria është ekonomikisht e lidhur me Italinë dhe Greqinë. Kjo strukturë dhjetjavjeare është e vështirë që të ndryshojë. Historia tregon se ekonomia i kalon kufijtë politikë. Arsyeja pse marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë kanë qenë dhe janë kaq të pakta ka të bëjë më shumë me mundësitë ekonomike të dy vendeve dhe asaj që ata mund t’i japin njëri-tjetrit, se sa me vullnetin politik ose çështjet historike.

---

<sup>6</sup> Sokol Lleshi, Dritan Sulçebe *Trade relations between Albania and Serbia*, AIIS, 2016

Por Shqipëria dhe Serbia nuk kanë çështje të pazgjidhura ndërmjet tyre. Shqipëria dhe Serbia as nuk ndajnë më një kufi mes tyre qëkur Kosova shpalli Pavarësinë në vitin 2008. Në vitin 2015 Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare botoi një studim mbi perceptimet që publiku shqiptar ka për Serbinë dhe marrëdhëniet Shqipëri-Serbi. Studimi tregoi se shqiptarët i perceptonin si normale marrëdhëniet me Serbinë dhe shumica e tyre prisnin që marrëdhëniet të përmirësoheshin në të ardhmen.<sup>7</sup> Gjithashtu shumica e të pyeturve thane se kërcënimi kryesor për Shqipërinë ishte Greqia dhe jo Serbia. Kjo është e kuptueshme sepse Shqipëria ndan një kufi me Greqinë dhe ka çështje të pazgjidhura ndërmjet të dy vendeve. Sidoqoftë, një shumicë e madhe prej 65% të përgjigjeve tregoi se asnjë shtet nuk ishte kërcënim për Shqipërinë.<sup>8</sup>

Por, ashtu siç e tregoi dhe studimi, problemi kryesor në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë, që tërthorazi ndikon mbi to dhe i pengon, është Kosova, ose më saktësisht pikëpamjet e ndryshme rreth të ardhmes së Kosovës. Është e vështirë të imagjinohen vërtetë marrëdhënie të mira Shqipëri-Serbi pa një zgjidhje përfundimtare të çështjes së Kosovës. 86% e të pyeturve thane se pengesa më e madhe në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë është “armiçësia historike ndërmjet dy kombeve” dhe “shtypja e shqiptarëve të Kosovës dhe trashëgimia kriminale e regjimit të Millosheviçit në Kosovë”.

Pothuajse të gjitha përgjigjet ndaj pyetjes mbi pengesën kryesore ndërmjet dy vendeve nuk kishin asnjë lidhje me problem të vërteta ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë. Gjithsesi, 61% e të pyeturve tha se Shqipëria dhe Serbia duhet të thellojnë marrëdhëniet e tyre pavarësisht Kosovës.

“Problemi” kryesor i drejtpërdrejtë ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë është niveli i ulët i njohurive për kulturën dhe historinë e njëri-tjetrit. Ky i kombinuar me çështjen e Kosovës ka çuar në një lloj indiference rreth Serbisë dhe marrëdhënieve Shqipëri-Serbi në publikun shqiptar dhe siç do të shihet edhe në këtë studim, gjithashtu edhe në shtypin shqiptar.

Në studimin e vitit 2015 nga Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare, pothuajse 85% e shqiptarëve nuk kanë qenë asnjëherë në Serbi dhe 80% e tyre nuk kanë lexuar kurrë një shkrimtar serb, megjithëse përkthime të tyre në gjuhën shqipe ka plot. Gjithashtu një anketim i

---

<sup>7</sup> Alba Cela, *Albania-Serbia relations in the eyes of the Albanian public 2015*, AIIS, Friedrich Ebert Stiftung, 2015

<sup>8</sup> Po aty.



ngjashëm i kryer në Serbi nxori në pah përqindje edhe më të mëdha. 98% e serbëve nuk kanë lexuar kurrë një shkrimtar shqiptar dhe 96% e tyre nuk kanë parë kurrë një film shqiptar. Ashtu siç ishte rasti në Shqipëri, edhe shumica e serbëve mendojnë se armiqësia historike ndërmjet të dy vendeve dhe çështja e Kosovës janë pengesat kryesore në marrëdhëniet Shqipëri-Serbi dhe jo ndonjë çështje specifike e drejtpërdrejtë.<sup>9</sup>

E shkuara tregon se ata që njohin pak zakonet, kulturën dhe historinë e njëri-tjetrit, priren të kenë më shumë paragjykitime për njëri-tjetrin. Një ndër hapat e parë për përmirësimin në të ardhmen të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë, gjendet pikërisht këtu.

Në përgjithësi, shqiptarët janë kuriozë të dinë më shumë për Serbinë dhe për të vendosur marrëdhënie më të ngushta me të. Kjo është një tokë pjellore për politikën në Shqipëri dhe Serbi për të bërë më shumë për të njohur njëri-tjetrin dhe për të ndërtuar marrëdhënie të ardhshme të bazuara mbi këtë dëshirë, sepse me njohjen vjen dhe bashkëpunimi ekonomik dhe politik.

### **Pse duhet vëzhguar media?**

Studimi i medias është i rëndësishëm sepse media është përgjegjëse në një masë të madhe për perceptimet tek publiku i përgjithshëm rreth një çështjeje të caktuar. Veçanërisht në këtë rast ku perceptimet që shqiptarët kanë për Serbinë janë përgjithësisht jo pozitive për shkak të teksteve të histories që çdo shqiptar lexon dhe meson që në vitet e para të shkollimit të tij. Çështja e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë është e mbushur me stereotipe të krijuara nga historian ndërmjet të dy vendeve dhe në këtë drejtim media mund të ndihmojë që këto stereotipe dhe perceptime të përgjithshme të tejkalohen. Ashtu siç u pa në vëzhgimin e mësipërm, “arsyet historike” janë pengesat më të rëndësishme në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë; veçanërisht rasti i Kosovës zë një pjesë të madhe në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Ashtu siç do të shihet gjithashtu edhe në këtë studim, në shtypin shqiptar Serbia shfaqet në një masë të madhe në lidhje me lajme që kanë lidhje edhe me Kosovën.

---

<sup>9</sup> Ipsos Marketing, *Public opinion in Serbia - Citizens' attitudes on Albania and Albanians and perception of relations Between peoples and states*, Friedrich Ebert Stiftung, European Movement in Serbia, 2015

Gjithashtu studimi i medias ndihmon për të kuptuar përceptimet e publikut shqiptar që u përmendën më sipër. Në këtë rast media nuk mund të ndihmojë për të kuptuar pse ato përceptime janë krijuar, për shkak se ato janë përceptime që janë krijuar nga historia e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Serbia. Media nuk i krijon ato, por media në një masë të madhe mund të ndihmojë për t'i përmirësuar përceptimet që shqiptarët kanë për Serbinë dhe marrëdhëniet shqiptaro-serbe. Ky rol i medias zgjerohet më shumë nga fakti, që siç e dëshmoi vëzhgimi i përmendur më sipër, pak shqiptarë e vizitojnë Serbinë, pak shqiptarë kanë ndonjë njohuri për letërsinë serbe dhe kulturën serbe në përgjithësi.

Roli i madh që media mund të luajë në këto raste është i mirënjohur. Për shembull, pas ndeshjes famëkeqe të futbollit ndërmjet Serbisë dhe Shqipërisë në tetor të 2014, kur një dron ndërpreu ndeshjen dhe shkaktoi përballje fizike ndërmjet lojtarëve, raportimi i ndeshjet në median serbe nuk ishte asnjans. Raportimi i zmadhoi përceptimet për nacionalizmin shqiptar dhe media pa ndonjë të dhënë krijoi lidhje ndërmjet dronit dhe skuadrës kombëtare shqiptare të futbollit, ndërkohë që më vonë u zbulua se droni ishte puna e një personi të vetëm pa ndonjë lidhje me kombëtaren shqiptare ose Federatën Shqiptare të Futbollit. Ky është një shembull që përshkruan ndikimin që media ka në një shoqëri komunikimi si kjo e jona.

## **2. Përmbledhje ekzekutive**

Në periudhën janar-qershor 2017 që ky studim mbulon, kishte pak çështje të drejtpërdrejta të rëndësishme në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë. Disa çështje të rëndësishme të muajve të kaluar si dhoma e përbashkët e tregtisë Serbi-Shqipëri ose projekti për autostradën Nish-Durrës nuk u shfaqën fare në shtypin shqiptar në periudhën e sipërpërmendur. Çështje të tjera, si vizita e presidentit Nishani në Preshevë dhe Bujanovc, e cila ishte vizita e pare e një presidenti shqiptar në ato komuna me shumicë popullsie shqiptare, u raportuan shumë pak në shtyp.

Një çështje e rëndësishme e brendshme e Serbisë si zgjedhjet presidenciale të 2 prill gjithashtu u raportua pak në median shqiptare. Serbia u shfaq në shkrimet në shtypin shqiptar më së shumti në lidhje me çështje të lidhura me Kosovën. Arrestimi i Haradinajt në Francë i bazuar mbi një urdhërarresti serb për krime të supozuara lufte, u paraqit gjerësisht. Gjithashtu çështja e trenit serb Beograd-Mitrovicë i lyer me mbishkrimet “Kosova është Serbi” në gjuhë të ndryshme dhe reagimet ndaj trenit në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi u raportuan dukshëm në median shqiptare.

Marrëdhëniet Serbi-Shqipëri ishin më pak të raportuara se çështjet e lidhura me Kosovën. Një prej e raportimeve ishin reagime nga Shqipëria dhe Serbia për Kosovën dhe disa të tjera ishin përgjithësisht shkrime positive për rritjen e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet të dy vendeve dhe disa aktivitete të përbashkëta kulturore. Konotacioni negative në këto shkrime ishte vetëm në 17% të rasteve, ndërkohë që 28% ishin pozitive dhe 55% asnjë (neutrale).

Përgjithësisht, Serbia dhe marrëdhëniet Serbi-Shqipëri janë më pak të raportuara në shtypin shqiptar se sa marrëdhëniet me Greqinë apo Kosovën. Fakti që Greqia dhe Kosova janë më të pranishme në shtypin shqiptar dhe ka më shumë interes për ato dy vende mund të shpjegohet në dy mënyra.

E para, ashtu siç u përmend dhe më sipër, në vëzhgimin e kryer nga Instituti Shqiptar për Studimeve Ndërkombëtare, shqiptarët e shikojnë Greqinë si kërcënimin kryesor, jo Serbinë. Shqipëria ndan një kufi me Greqinë dhe ka disa çështje ende të pazgjidhura ndërmjet dy vendeve. E dyta, në anën tjetër, Shqipëria nuk ka kufi me Serbinë dhe nuk ka asnjë çështje të pazgjidhur ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë. Kjo e kufizon konsiderueshëm interesin e shtypit shqiptar për Serbinë dhe marrëdhëniet Serbi-Shqipëri.

Ky studim u përpoq t’i përgjigjej dy pyetjeve: “*cilat* janë çështjet kryesore të raportuara në shtypin shqiptar gjatë kësaj periudhe 6 mujore në lidhje me Serbinë dhe marrëdhëniet Serbi-Shqipëri?” dhe “*si* i raportoi shtypi shqiptar këto marrëdhënie?”. Përgjigja ndaj këtyre dy

çështjeve të *cilave* dhe *si* jep një pamje të përgjithshme të mënyrës së si Serbia dhe marrëdhëniet Serbi-Shqipëri janë raportuar në shtypin shqiptar. Studimi tregon se raportimi është më së shumti *rrethanor* i varur nga çështje të caktuara në një moment të caktuar, por gjithashtu ka një prani të vazhdueshme të Serbisë në shtypin shqiptar gjatë gjithë periudhës së përfshirë në këtë studim.

### **Çfarë është raportuar?**

Në këtë studim u analizua një përbërës prej 131 shkrimesh të shtrira në 6 muaj dhe në 4 gazeta: tre të përditshme në gjuhën shqip – Mapo, Panorama, Shqiptarja.com; dhe një e përjavshme në gjuhën angleze – Tirana Times. Ky studim tregon se Serbia dhe marrëdhëniet Serbi-Shqipëri janë më pak të raportuar në shtypin shqiptar se sa vendet si Kosova dhe Greqia. Intensiteti i raportimit ishte i varur mbi disa çështje që tërhoqën vëmendjen e publikut në momente të caktuara. Janari ishte muaji kulmor me 41 shkrime, ndërkohë që muaji shkurt kishte vetëm 9. Katër muajt e tjetër ishin pothuajse njëjloj me nga 18 deri në 23 shkrime secili. *Tirana Times* ishte gazeta me më shumë shkrime, 42 përkatësisht, pak më shumë se dy të përditshmet e tjera në gjuhën shqip *Panorama* dhe *Shqiptarja.com*, me 35 shkrime secila. *Tirana Times* ishte gjithashtu gazeta me më shumë shkrime pozitive, 21% të të gjitha shkrimeve të saj kishin konotacion pozitiv.

Janari si muaj kulmor i raportimit shpjegohet me disa çështje të lidhura me Kosovën në atë muaj, të cilat u pasqyruan gjerësisht në shtypin shqiptar. Arrestimi i Ramush Haradinajt në Francë, treni serb Beograd-Mitrovicë, muri në pjesën serbe të Mitrovicës në Kosovën e veriut dhe regimet e zyrtarëve të lartë në Shqipëri, Serbi dhe Kosovë për këto çështje, çuan në një numër të lartë shkrimesh në janar.

Disa çështje të tjera si zgjedhjet presidenciale në Serbi, marrëdhëniet e drejtpërdrejta ndërmjet Serbisë dhe Shqipëri, ishin të pranishme në median shqiptare veçanërisht në muajt mars dhe prill.

86% e të gjithë shkrimeve në shtypin shqiptar ishin politike, ndërkohë që vetëm 6% ishin kulturore ose sportive dhe 5% ekonomike. E përjavshmja në gjuhën angleze *Tirana Times* kishte shumicën e shkrimeve për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë. Ky përqëndrim tek politika tregon se shtypi shqiptar prirët të shkojë pas *historive të bujshme* që mund të krijojnë tituj të faqeve të para. Ngjarjet që krijuan tituj të tillë në janar, pothuajse ishin harruar në shkurt.

### **Si u raportua?**

Përveç majtes sasiore, ky studim përqëndrohet gjithashtu edhe mbi analizën e përmbajtjes së shkrimeve duke e vënë theksin tek konotacioni. Ky studimi vendosi katër lloje konotacioni: asnjans (neutral), pozitiv, negativ dhe thuajse negative. Vlerësimi i konotacionit u bë mbi bazën e gjuhës së përdorur në shkrim dhe nëse autori i shprehte ose jo mendimet dhe pikëpamjet e tij.

Shumica dërmuese e shkrimeve të analizuara në këtë studim kishin një konotacion asnjans. 70% e tyre ishin asnjans, ndërkohë që 16% ishin negative dhe vetëm 9% pozitive. Studimi tregon se konotacioni varej nga çështja që po raportohej. Konotacioni negative ishte më së shumti në shkrime që lidheshin me Kosovën, ndërsa konotacioni pozitiv në shkrime që lidheshin me bashkëpunimin ekonomik apo kulturor shqiptaro-serb.

Të gjitha gazetat e analizuara në këtë studim kishin një shumicë të konotacionit asnjans në shkrimet e tyre. *Shqiptarja.com* kishte në 94% të rasteve konotacion asnjans, *Panorama* 70% dhe *Mapo* 63%. *Mapo* dhe *Panorama* ishin gazetat me më shumë konotacion negative në shkrimet e tyre, me 26 dhe 27 përqind përkatësisht. Ndërsa *Tirana Times* ishte gazeta që kishte më pak shkrime me konotacion asnjans, 52%.

Nga ngjarjet që u raportuan më shumë, nuk kishte asnjë që të kishte një shumicë konotacioni pozitiv, por gjithashtu nuk kishte asnjë që të kishte shumicë konotacioni negative. Të gjitha ngjarjet që u raportuan më shumë kishin një shumicë konotacioni asnjans.

Nëse të dhënat e analizuar në këtë studim, vlerësohen pa çështjet e lidhura me Kosovën dhe përqëndrohen vetëm tek marrëdhëniet e drejtpërdrejta Serbi-Shqipëri ose në çështje të brendshme të Serbisë të raportuara në shtypin shqiptar, konotacioni asnjëherë dhe ai pozitiv do të ishin shumë të mëdha.

Studimi tregon se nuk ka një çështje kryesore që zgjatet përgjatë gjithë shkrimeve. Raportimi për Serbinë dhe marrëdhëniet Serbi-Shqipëri është më së shumti i varur nga *rrethanat*, i bazuar në disa çështje të "nxehta" për një periudhë të caktuar kohe që më vonë mbarojnë. Madje dhe raportimi për Serbinë i lidhur me Kosovën nuk është një temë e vazhdueshme, por është e varur nga ngjarje të caktuara.

### **3. Metodologjia**

Metodat parësore e kërkimit e zgjedhur për këtë studim është *analiza e përmbajtjes*, një vëzhgim sasior dhe cilësor i medias. Përmbajtja që analizohet përbëhet nga artikuj të shtypit të shkruar shqiptar. Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare e ka përdorur këtë metodë suksesshëm edhe në studime të ngjashme të mëparshme si ato për Kosovën<sup>10</sup> dhe Greqinë<sup>11</sup> në shtypin shqiptar.

### **Përzgjedhja e kampionit**

---

<sup>10</sup> Dritan Sulçebe, *Kosova dhe marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë në shtypin e shkruar shqiptar 2016*, AIIS, Tiranë 2016

<sup>11</sup> Sashenka Lleshaj, Dritan Sulçebe, *Greece and the Albanian-Greek relations in the Albanian printed media 2014*, Albanian Institute for International Studies and Friedrich Ebert Stiftung, Tirana 2014

Për këtë studim janë vëzhguar tre gazeta të përditshme – Mapo, Panorama dhe Shqiptarja.com – dhe një gazetë përjavore në gjuhën angleze – Tirana Times. Kjo zgjedhje është bërë *a priori* duke u bazuar në numrin e kopjeve që secila prej këtyre gazetave shet, ndërkohë që Tirana Times është zgjedhur për shkak të lexuesve anglishtfolës që ka në Tiranë dhe që përgjithësisht përbëhet nga misionet e huaja diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare në Shqipëri.

Pas përzgjedhjes, këto gazeta u vëzhguan për një periudhë gjashtëmujore, nga janari në qershorin e vitit 2017. Kjo periudhë kohore u zgjodh për shkak se pasonte një periudhë kur marrëdhëniet shqiptaro-serbe morën hov, vizitës së dytë të kryeministrit shqiptar Edi Rama në Beograd gjatë Forumit të Sigurisë në Beograd, ashtu si dhe pas krijimit të Dhomës së përbashkët të tregtisë Shqipëri-Serbi, dy ngjarje që priteshin të pasoheshin me lajme në shtypin shqiptar.

Për të patur një përfaqësim sa më të plotë të lajmeve për Serbinë dhe marrëdhëniet shqiptaro-serbe në shtypin shqiptar, vëzhgimi u krye bazuar mbi rreth 12 fjalësh kyçe si: Serbia, Vuçiç, Beograd, dhoma e tregtisë Shqipëri-Serbi, treni Beograd-Mitrovicë, bashkëpunimi shqiptaro-serb, dialogu Serbi-Kosovë etj.

### **Përcaktimi i konotacionit**

Në këtë studim, analiza e përmbajtjes së shkrimeve, gjuha e përdorur për të dhënë lajmin, është e një rëndësie themelore, pasi është pikërisht gjuha e përdorur për të përçuar diçka, jo vetëm ajo që përçohet, që ndikon mbi përshtypjen që mund të lërë mbi lexuesin shqiptar një shkrim për Serbinë.

Në këtë studim fillimisht ishin përcaktuar tre nivele të ndryshme të konotacionit, gjuhës së përdorur: *negative, pozitive dhe neutrale (asnjanëse)*. Kjo ndarje e kategorive kryesore të konotacionit është paksa arbitrare dhe ka pasur raste kur dallimi ndërmjet negatives dhe

asnjanëses nuk ka qenë lehtësisht i përcaktueshëm. Ka pasur raste kur gjuha e përdorur dhe qëndrimi i autorit kanë qenë asnjanëse, por në vende të caktuara ishin përdorur fjalë dhe shprehje me një konotacion negativ ose ironik, por që nuk ishin të mjaftueshme për ta përcaktuar të gjithë shkrimin si negativ. Për këtë qëllim në disa shkrime është përdorur një konotacion tjetër për të përshkruar përmbajtjen: *thujse-negativ*. Gjykimi për konotacionin e përdorur është bazuar mbi shprehje të caktuara të përdorura që japin një ton të caktuar një shkrimi. Mënyra se si një shkrim është gjykuar të ketë një konotacion negative, pozitiv, asnjanës ose thujse-negativ ka qenë e paracaktuar, në mënyrë për të qenë sa më të saktë që të jetë e mundur në analizë. Kategorizimi është bërë në këtë mënyrë:

- Një shkrim është cilësuar si me konotacion *negativ* (1) nëse në të janë përdorur fjalë të tilla si konflikt, keqtrajtim, mosbesim; (2) autori i shkrimit ka shprehur dukshëm qëndrimin e tij, opinionin vetjak për atë çështje pa dhënë dhe palët tjetër; (3) ka pasur foto ose kutiza të cilat shprehin nëpërmjet pamjes një qëndrim negativ.
- Një shkrim është vlerësuar si *asnjanës* (neutral) kur autori ka paraqitur faktet pa dhënë mendimin e tij vetjak, ka paraqitur të gjitha palët e përmendura në shkrim me citimet përkatëse, kur gjuha e përdorur ka qenë e moderuar dhe sa më e ftohtë dhe profesionale. Në përgjithësi gjuha e përdorur dhe fotot shoqëruese të përdorura nuk kanë lënë ndonjë përshtypje negative ose pozitive mbi lexuesin.
- Një shkrim është vlerësuar si *pozitiv* kur janë përdorur fjalë ose shprehje si bashkëpunim, mirëkuptim, përmirësim, mbështetje, etj. Gjithashtu kur shkruesi e ka vënë në dukje se një ngjarje e tillë është pozitive, se i shërben përmirësimit të marrëdhënieve, çuarjes më tej të tyre.
- Një shkrim është vlerësuar të ketë një konotacion *thujse-negativ* kur fjalët e përdorura kanë qenë në disa raste negative, por mendimet dhe pikëpamjet e autorit nuk janë paraqitur, ose janë paraqitur të gjitha palët; ose kur mendimet e autorit janë dhënë duke lënë kështu një përshtypje të keqe tek lexuesit, por gjuha e përdorur ka qenë anjanëse.



Zakonisht këto shkrime mund të ishin vlerësuar dhe si negative, por këtu është shtuar një kategori e katërt për të dalluar ato shkrime që kanë qenë plotësisht negative në gjuhën e tyre dhe pikëpamjet e autorit dhe atyre shkrimeve në të cilat një prej këtyre përbërësve ka qenë asnjans.

Këto përcaktime janë vetëm një udhërrëfyes i përgjithshëm për të përshkruar brendinë e shkrimeve të analizuara në këtë studim, pasi është e pamundur me qenë plotësisht objektiv në lidhje me konotacionin e një shkrimi. Gjithashtu, në një masë të konsiderueshme, një ndarje e tillë e prerë mes konotacionit negativ, pozitiv dhe asnjans ka qenë e pamundur, për shkak se ka pasur raste kur një shkrim ka qenë përgjithësisht asnjans (neutral) por në momente të caktuara ka përdorur shprehje apo fjalë që mbartin një konotacion negativ ose ironik por në këto raste i gjithë shkrimi nuk mund të thuhet se ka konotacion negativ por gjendet midis negatives dhe asnjanses.

#### **4. Gjetjet kryesore dhe analiza**

Në këtë kapitull, paraqitja e Serbisë dhe e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Serbisë në shtypin shqiptar, do të jepet në dy pjesë. Në të parën do të ketë një përshkrim të tablosë së përgjithshme të shkrimeve të analizuara për këtë studim, të numrit të përgjithshëm të tyre dhe më pas të ndara sipas gazetave. Gjithashtu do të jepen çështjet kryesore që janë raportuar në shtypin shqiptar në lidhje me Serbinë dhe marrëdhëniet Shqipëri-Serbi, muajt kur ka pasur më shumë shkrime dhe cilat gazeta kanë pasur më shumë.

Pjesa e dytë do të jetë e përqëndruar në tre raste studimore. Janë zgjedhur pikërisht tre raste dhe jo dy si në studimet e ngjashme të kaluara që ka realizuar Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, për shkak të veçanësisë së paraqitjes së Serbisë dhe marrëdhënieve Shqipëri-Serbi në shtypin shqiptar, ndryshe nga paraqitja e marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë dhe


Shqipëri-Greqi. Me këto tre raste studimore vëzhgohet dhe kuptohet se si dhe sa paraqitet një çështje e rëndësishme e politikës serbe në shtypin shqiptar, siç është zgjedhja e presidentit të ri serb; gjithashtu shikohet se sa paraqitet marrëdhënia Shqipëri-Serbi në shtypin shqiptar, sa e rëndësishme është për shtypin dhe në ç'mënyrë paraqitet. Në rastin e tretë studimor, atë të marrëdhënieve Serbi-Kosovë në shtypin shqiptar, kuptohet diçka shumë e rëndësishme kur studiohet paraqitja e Serbisë në shtypin shqiptar: që në një masë të madhe Serbia në shtypin shqiptar shfaqet në lajme që kanë lidhje me Kosovën.

### **Vëzhgim i përgjithshëm**

Në krahasim me dy studimet e mëparshme të kryera nga Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare në lidhje me Kosovën dhe Greqinë, nga ky studim rezulton se Serbia dhe marrëdhëniet Shqipëri-Serbi shfaqen më pak në shtypin shqiptar se dy rastet e kaluara. Ndërkohë që për Kosovën dhe marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë ishin gjithsej 227 shkrime të vlefshme për t'u analizuar, dhe për Greqinë dhe marrëdhëniet Shqipëri-Greqi ishin gjithsej 225 shkrime të analizuara, për Serbinë dhe marrëdhëniet Shqipëri-Serbi ishin gjithsej 81 shkrime të vlefshme për këtë studim.

Kjo paraqitje relativisht e paktë e Serbisë dhe marrëdhënieve Shqipëri-Serbi në shtypin shqiptar në krahasim me Kosovën dhe Greqinë, përkon me përshtypjet që publiku shqiptar ka në përgjithësi për Serbinë dhe për informacionin e paktë që ka publiku shqiptar për Serbinë. Gjithashtu siç do të vihet re edhe më poshtë, në një masë të konsiderueshme, Serbia shfaqet në shtypin shqiptar në lidhje me Kosovën.

Prej 131 shkrime të analizuara në këtë studim, shumica e tyre është botuar nga e përjavshmja në gjuhën angleze *Tirana Times*.




Grafiku 1

*Tirana Times* kishte 42 shkrime, ndërsa *Panorama* dhe *Shqiptarja.com* kishin secila nga 35 shkrime, pak më pak se gazeta në gjuhën angleze dhe *Mapo* kishte më pak nga të gjithë me 19 shkrime. Kjo ndarje e shkrimeve ku *Tirana Times* është e para shpjegohet nga fakti që *Tirana Times* është më e vëmendshme ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare në krahasim me gazetat e përditshme. Gjithashtu *Tirana Times* raporton rregullisht aktivitetet e Institutit Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, që organizon shumë aktivitete në lidhje me marrëdhëniet Shqipëri-Serbi.

Për më tepër, shkrimet u rradhitën në bazë të fokusit të tyre, nëse ishin drejtpërdrejt të lidhura me marrëdhëniet Shqipëri-Serbi ose ishin të lidhura me çështje të brendshme të Serbisë që mund të kishin një ndikim të tërthortë mbi marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Prej 131 shkrimeve të analizuara në këtë studim, vetëm 55 prej tyre, pothuajse 42% e gjithë shkrimeve

ishin të përqëndruara drejtpërdrejt në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë ose në çështje të brendshme të Serbisë. Kjo përqindje deri diku e vogël e të gjithë shkrimeve të analizuar në këtë studim që ose janë të përqëndruara tek marrëdhëniet Shqipëri-Serbisë ose mbi çështjet e brendshme të Serbisë, shpjegohet nga fakti se në shumë shkrime të analizuar në këtë studim, Serbia shfaqej në shtypin shqiptar përmes lajmeve të lidhura me çështjen e Kosovës, e cila nuk mund të rrëdhitet si një çështje e brendshme e Serbisë dhe as si e lidhur drejtpërdrejt me marrëdhëniet Shqipëri-Serbi.



Grafiku 2

Prej këtyre 55 shkrimeve, shumica (39) ishin të përqëndruara në çështje të brendshme të Serbisë, veçanërisht në zgjedhjet presidenciale të prillit 2017 dhe të tjerat mbi marrëdhëniet e Serbisë me Bashkimin Evropian. Prej 16 shkrimeve që përqendroheshin drejtpërdrejt në marrëdhëniet Shqipëri-Serbi, disa prej çështjeve më të rëndësishme ishin vizita e Presidentit shqiptar në Serbi në komunat me shumicë shqiptare të Preshevës dhe Bujanovcit dhe bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë, veçanërisht në fushën e ekonomisë.

Veç kësaj rradhitjeje të bazuar mbi fokusin, shkrimet gjithashtu u kategorizuan në bazë të çështjeve kryesore që ishin raportuar në gjashtë muajt që mbulon ky studim. Çështjet më të rëndësishme ishin: zgjedhjet presidenciale në Serbi, marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Shqipërisë, arrestimi i Haradinajt, marrëdhëniet Serbi-Kosovë, vizita e Nishanit në Serbi.




Grafiku 3

Ashtu siç shihet nga grafiku 3, Serbia shfaqet në shtypin shqiptar më së shumti përmes Kosovës dhe marrëdhënieve Serbi-Kosovë. Çështja e arrestimit të Haradinajt gjithashtu është një çështje ku Serbia shfaqet në shtypin shqiptar përmes një çështjeje të lidhura me Kosovën dhe jo drejtpërdrejt me marrëdhëniet Shqipëri-Serbi. Kjo është e rëndësishme për t'u vënë në dukje, sepse tregon se çështja më me interes për shtypin shqiptar në lidhje me Serbinë është Kosova dhe çështjet e lidhura me marrëdhëniet Serbi-Kosovë. Grafiku dhe përfundimet tregojnë se këto çështje janë shumë më interesante për shtypin shqiptar se çështjet e lidhura drejtpërdrejt me marrëdhëniet Shqipëri-Serbi ose ndonjë çështje e rëndësishme e brendshme e Serbisë si


zgjedhjet presidenciale, rezultati i të cilave kishin një ndikim të tërthortë mbi të gjithë rajonin. Madje edhe një vizitë historike në Serbi nga Presidenti shqiptar Bujar Nishani raportohet pak në shtypin shqiptar.

Kur është fjala tek *shpërndarja mujore e shkrimeve* kulmi arrihet në janar, gjë që shpjegohet nga fakti se në atë muaj ishte arrestimi i Haradinajt në Francë, që u raportua gjerësisht në shtypin shqiptar. Gjithashtu në janar ishte rasti i trenit serb Beograd-Mitrovicë i lyer me mbishkrime nacionaliste, që në këtë studim është përfshirë në marrëdhëniet Serbi-Kosovë. Muaji prill përkon me zgjedhjet presidenciale në Serbi, që gjithashtu u raportuan konsiderueshëm në median shqiptare.



Grafiku 4

Nga grafiku është e dukshme se ka lëvizje të mëdha në raportimin për Serbinë dhe marrëdhëniet Shqipëri-Serbi. Për shembull muaji shkurt ka vetëm 9 shkrime, nga 41 një muaj më parë. Për katër muajt e tjetër nuk ka ndonjë dallim të madh në raportim. Ashtu siç tregon grafiku tjetër për shpërndarjen mujore të shkrimeve sipas gazetave ka një lëvizje të madhe ndërmjet janarit dhe shkurtit për gazeta të ndryshme, por ka gjithashtu lëvizje të mëdha ndërmjet gazetave edhe në të njëjtin muaj, siç është rasti i janarit.




Grafiku 5

Për shembull, në janar *Panorama* ka 15 shkrime ndërsa *Shqiptarja.com* dhe *Mapo* vetëm nga 7 dhe 8 përkatësisht. Në mars gjithashtu ka dallim të madh ndërmjet gazetave. *Shqiptarja.com* ka 9 shkrime në mars, ndërsa *Panorama* vetëm 1. Në prill *Tirana Times* ka 8 shkrime, ndërsa *Mapo* vetëm 2.

Kjo lëvizje e madhe nuk është vetëm brenda një muaji për gazeta të ndryshme, por edhe për një gazetë në muaj të ndryshëm. Duke analizuar një gazetë nga numri i shkrimeve mujore,

shikohet se për shembull *Panorama* shkon nga 15 shkrime në janar në vetëm 1 në mars ose 2 në shkurt.

Së fundi shkrimet gjithashtu u rradhitën sipas natyrës së tyre: politikë, shoqëror, kulturë dhe sport. Shumica dërrmuese e shkrimeve ishin politikë, 86% e 131 shkrimeve. Një fraksion i tyre ndahej mes kulturë\sport, ekonomisë dhe çështjeve shoqërore. Megjithëse Shqipëria dhe Serbia krijuan një dhomë të përbashkët tregtie tetorin e kaluar, çështjet ekonomike u raportuan shumë pak në shtypin shqiptar. Një pjesë e 6% që kultura ndan me sportin nuk lidhet drejtpërdrejt me marrëdhëniet Shqipëri-Serbi, por është për shkak të faktit që sportisti shqiptar i kërcimit sëlarti, Izmir Smajlaj fitoi medalje të artë në Kampionatin e Atletikës të organizuar në Beograd.



Grafiku 6

**Konotacioni: si u raportuan çështjet**




Analiza e numrit të shkrimeve në përgjithësi dhe në veçanti për secilën gazetë dhe analiza e çështjeve kryesore që u raportuan nuk është e mjaftueshme. Për të patur një kuptim më të mirë dhe më të plotë se si shtypi shqiptar raporton lajmet për Serbinë dhe marrëdhëniet Shqipëri-Serbi, është e rëndësishme të analizohet konotacioni i shkrimeve. Në këtë mënyrë mund të përfitojmë një kuptim të çështjeve të ndryshme të raportuara, si janë paraqitur aktorët kryesorë, politikanët, diplomatët, etj. Duke analizuar konotacionin mund të kuptojmë pse është zgjedhur një titull i caktuar ose është përdorur një foto e caktuar. Gjithashtu, përmes konotacionit mund të kuptojmë pikëpamjen e një gazete të caktuar për Serbinë dhe marrëdhëniet Shqipëri-Serbi.



Grafiku 7

Ashtu siç u shpjegua më herët, 131 shkrimet e përfshira në këtë studim u rradhitën në bazë të katër kategorive të konotacionit: neutral (asnjanës), negative, pozitiv dhe thujse-negativ. Ashtu siç tregon grafiku 7 shumica dërrmuese e shkrimeve kishte një konotacion neutral. Në to gjuha e përdorur ishte e moderuar pa shprehur pikëpamjet dhe mendimet e autorit. 16% e shkrimeve kishin një konotacion negative dhe vetëm 9% ishin positive. Shkrimet që kishin

konotacion pozitiv ishin më së shumti për çështje kulturore dhe bashkëpunimin e fundmë ekonomik. Shkrimet që kishin një konotacion negative ishin për çështje më së shumti të lidhura me Kosovën dhe arrestimin e Haradinajt në Francë.



Grafiku 8

Të gjitha gazetat e përfshira në këtë studim kishin një shumicë të konotacionit neutral. *Shqiptarja.com* kishte më shumë se të tjerët, 94% e shkrimeve të saj kishin një konotacion neutral. *Panorama* ishte e dyta me 76% të shkrimeve me konotacion neutral. Gazeta me shkrimet më positive ishte *Tirana Times*, ndërsa gazeta me më pak shkrime positive ishte *Panorama*, që nuk kishte asnjë. *Panorama* dhe *Mapo* ishin gazetat me më shumë shkrime negative, me 27 dhe 26 përqind përkatësisht. Gazeta me më pak konotacion negativ ishte *Shqiptarja.com* me 3%.

## **Raste studimore**

Pasi kemi paraqitur një pamje të përgjithshme të Serbisë dhe marrëdhënieve Serbi-Shqipëri në shtypin shqiptar, kjo pjesë do të japë një vëzhgim më të thellë rreth tre çështjeve specifike të raportuara në periudhën gjashtë mujore që ky studim mbulon. Zgjedhja e rasteve studimore të analizuar është bërë për të dhënë një kuptim të trefishtë të mënyrës se si shtypi shqiptar e raporton Serbinë dhe marrëdhëniet Serbi-Shqipëri. Tre rastet studimore janë: zgjedhjet presidenciale në Serbi, marrëdhëniet Serbi-Shqipëri dhe marrëdhëniet Serbi-Kosovë.

Rasti i parë, ai i zgjedhjeve presidenciale në Serbi mund të na bëjë të kuptojmë se si raportohet në shtypin shqiptar një çështje e brendshme e Serbisë me ndikim të mundshëm mbi të gjithë rajonin. Analiza e rastit të dytë, ajo e marrëdhënieve Shqipëri-Serbi, është një ndër pikat kyçe të këtij studimi. Tregon se sa i interesuar është shtypi shqiptar për këtë çështje. Dhe rasti i tretë, ai i marrëdhënieve Serbi-Kosovë, tregon se një prej gjërave më të rëndësishme kur marrim në konsideratë marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Shqipërisë: roli i Kosovës.

## **1. Çështja e brendshme: zgjedhjet presidenciale në Serbi**

Tomislav Nikoliç, President i Serbisë qëkur mundi Boris Tadiçin në raundin e dytë të zgjedhjeve në vitin 2012, vendosi të mos kandidojë për një mandat të dytë. Vendimi i tij ishte i detyruar për shkak se partia më e madhe politike në Serbi, Partia Progresive, e themeluar nga Nikoliç por e drejtuar nga Kryeministri Aleksandar Vuçiç, nuk e mbështeti Nikoliçin për një mandat të dytë. Nikoliç kishte qenë një President i dobët, i lënë në hije nga Kryeministri Vuçiç, megjithëse Serbia është një republik gjysmë-presidenciale. Ndërkohë, Partia Progresive si kandidat për President propozoi vetë kryeministrin Vuçiç. Në këtë mënyrë, qendra e fuqisë politike në Serbi do të zhvendoset nga kryeministri që do të jetë një figurë e dobët, ashtu siç ishte gjatë presidencës së Boris Tadiçit, tek Presidenti i ri.


Në zgjedhjet e mbajtura në 2 prill Vuçiç fitoi shumicën absolute që në raundin e parë. Ai mori 55% të votave, ndërkohë që kundërshtari i tij më i afërt ishte Sasha Jankoviç me 16% të votave. Rezultatet e zgjedhjeve presidenciale në Serbi, u ndoqën nga afër në vendet e tjera të rajonit, për shkak të ndikimit që rezultati mund të kishte mbi gjendjen e përgjithshme në Ballkan. Fakti që Vuçiçi ishte favoriti për të fituar do të thoshte se pak do të ndryshonte në politikën e jashtme të Serbisë.

Kjo ishte e rëndësishme dhe për Shqipërinë dhe marrëdhëniet Shqipëri-Serbi, për shkak se Vuçiç dhe kryeministri shqiptar Edi Rama duket se kanë krijuar një marrëdhënie të ngushtë në 2-3 vitet e fundit me mbështetjen edhe të Bashkimit Evropian. Fitorja e Vuçiçit në zgjedhje do të thotë se kjo marrëdhënie vështirë se do të ndryshojë. Përkundrazi, përmirësimet që kanë ndodhur në vitet e fundit në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, pikërisht edhe për shkak të kësaj marrëdhënieje Rama-Vuçiç, tashmë mund të përforcohen. Rama fitoi shumicën absolute në zgjedhjet

parlamentare të 25 qershorit dhe kështu ka dorë të lirë ta realizojë politikën e jashtme të Shqipërisë ashtu siç dëshiron, ndërkohë që Vuçiç gjithashtu duke u zgjedhur President dhe duke vendosur një figureë të dobët në postin e Kryeministrit, mund të vazhdojë të bëjë të njëjtën gjë me politikën e jashtme të Serbisë. Për shkak të kësaj rëndësie në marrëdhëniet Shqipëri-Serbi, është interesante për të parë se si u paraqitën në median e shkruar shqiptare zgjedhjet presidenciale në Serbi.


Gjithashtu analiza e kësaj çështjeje na lejon të shikojmë se si pasqyrohet në median shqiptare një çështje e brendshme e Serbisë dhe sa është interesi për çështje të këtij lloji, ndikimi i së cilave shkon përtej kufijve të Serbisë.

Në përgjithësi, media e shkruar shqiptare tregoi pak interes për zgjedhjet presidenciale në Serbi. Vetëm 11 shkrime nga 131 të analizuar në këtë studim ishin për këtë çështje, ndërkohë që një prej gazetave të vëzhguara nga ky studim nuk kishte asnjë shkrim. *Shqiptarja.com* dhe *Panorama* kishin shumicën e shkrimeve, me 6 dhe 4 shkrime përkatësisht. Shumica e tyre ishin një raportim i thjeshtë lajmi. Nuk kishte shkrime të thelluara për zgjedhjet presidenciale në një vend shumë afër me Shqipërinë dhe nuk kishte asnjë shkrim që të shpjegonte rrjedhojat e fitores së Vuçiçit për marrëdhëniet Shqipëri-Serbi. Mund të thuhet se raportimi për këtë çështje ishte përgjithësisht sipërfaqësor.



Grafiku 9


Meqë zgjedhjet u mbajtën në muajin prill, edhe kulmi i raportimit të kësaj çështjeje ishte po në muajin prill me 8 shkrime. Është e kuptueshme që në muajt janar dhe shkurt nuk pati asnjë shkrim, por as në muajin mars, një muaj para zgjedhjeve, nuk kishte asnjë shkrim për këtë çështje në median e shkruar shqiptare të analizuar në këtë studim, për zgjedhjet e ardhshme në Serbi, për kandidatët e mundshëm, etj. Shkrimet në muajt maj dhe qershor ishin më tepër për pasojat e fitores së Vuçiqit në zgjedhje, veçanërisht për kryeministren e re.



Grafiku 10

### **Konotacioni**

Nga 11 shkrimet në median shqiptare, vetëm 1 prej tyre kishte konotacion negativ, në lidhje me gjendjen në Serbi pas zgjedhjeve presidenciale.



Grafiku 11

## 2. Çështja qendrore: Marrëdhëniet Shqipëri-Serbi

Ashtu siç u përmend dhe më herët në këtë studim, marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë janë përmirësuar shumë në vitet e fundit. Kryeministri shqiptar Edi Rama ishte i pari kryeministër shqiptar që vizitonte Beogradin në nëntor të vitit 2014 qysh nga viti i largët 1946 kur për herë të fundit kishte qenë Enver Hoxha. Vizita e Ramës erdhi një muaj pas dronit të famshëm që ndërpreu ndeshjen e futbollit ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë në Beograd dhe nxiti përleshje fizike ndërmjet lojtarëve me njëri-tjetrin dhe ndërmjet lojtarëve shqiptarë dhe tifozëve të cilët u futën në fushë. Sidoqoftë, vizita e Ramës ishte planifikuar përpara ndeshjes dhe nuk u bë për shkak të saj.

Media serbe e interpretoi vizitën e Ramës si një dron të dytë, këtë herë me fjalë, pas atij fizik në stadium.<sup>12</sup> Media shkroi se sjellja e Ramës gjatë vizitës në Beograd ishte një ‘‘provokacija’’ tjetër pas dronit. Ivica Daçiç, Ministri serb i Punëve të Jashtme tha se vizita e Ramës nuk ishte

<sup>12</sup> <http://www.blic.rs/vesti/politika/sest-provokacija-edija-rame-albanski-premijer-ka-verbalni-dron/t1snfm5>

një hap përpara, por “krijoi tensione në të dyja anët”.<sup>13</sup> Pavarësisht fjalëve të Daçiçit, fakti që kryeministrat e Shqipërisë dhe të Serbisë mund të takohen dhe të diskutojnë lehtësisht për bashkëpunimin e të dy vendeve dhe për gjendjen e përgjithshme në rajon, është një hap i rëndësishëm përpara.

Vizita e dytë zyrtare e Ramës në Serbi u zhvillua në tetor 2016 kur së bashku me kryeministrin serb morën pjesë në Forumin e Sigurisë në Beograd. Pak ditë pas Forumit Rama dhe Vuçiç ishin të pranishëm në qytetin e Nishit në jug të Serbisë në prezantimin e dhomës së përbashkët të tregtisë Shqipëri-Serbi. Të gjitha këto zhvillime paraqesin një gjendje shumë më të relaksuar se disa vite më parë.

Në gjashtë muajt e fundit nuk ka pasur ndonjë çështje të veçantë në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë. Vetëm në muajin janar pati disa deklarata të ashpra kundër njëri-tjetrit për shkak të arrestimit të Haradinajt në Francë dhe të trenit serb Beograd-Mitrovicë. Por këto dy çështje nuk ishin të lidhura drejtpërdrejtë me marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Serbisë. Pas zhvillimeve të rëndësishme të muajve të fundit të vitit 2016, gjysma e parë e 2017-tës ka qenë e qenë në aksin Beograd-Tiranë.


### **Të dhëna të përgjithshme mbi vëzhgimin**

Marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë ishin relativisht të pasqyruara në këtë periudhë. Sidoqoftë, nuk pati shumë shkrime në median e shkruar shqiptare siç mund të pritej pas zhvillimeve të fundvitit 2016. Shumica e shkrimeve për marrëdhëniet Shqipëri-Serbi ishin në muajin janar, ndërkohë që në shkurt nuk kishte asnjë dhe në mars dhe qershor vetëm nga një shkrim përkatësisht. Numri më i madh i shkrimeve në muajin janar në krahasim me muajt e tjerë shpjegohet nga arrestimi i Ramush Haradinajt në Francë dhe trenin serb Beograd-Mitrovicë, gjatë të cilave pati disa deklarata të ashpra nga zyrtarët e lartë politikë.

---


<sup>13</sup> Po aty.





Grafiku 12

Ashtu siç tregon dhe grafiku 13 më poshtë pati barazi ndërmjet gazetave të ndryshme në lidhje me shkrimet për marrëdhëniet Shqipëri-Serbi. Gazetat *Panorama* dhe *Tirana Times* kanë nga 5 shkrime secila, ndërkohë që gazetat *Mapo* dhe *Shqiptarja.com* nga 4 shkrime.



Grafiku 13

## Konotacioni

Në këtë rast analiza e konotacionit të shkrimeve është shumë e rëndësishme pasi na lejon të shikojmë drejtpërdrejtë se si paraqitet Serbia në shtypin e shkruar shqiptar.



Grafiku 14

Më shumë se gjysma e shkrimeve kanë një konotacion neutral (asnjanës), ndërkohë që 17% e shkrimeve kanë konotacion negativ. Pothuajse një e treta e shkrimeve janë pozitive. Konotacioni pozitiv është më së shumti në shkrimet që kanë lidhje me bashkëpunimin kulturor ndërmjet dy vendeve, ndërsa konotacioni negativ përdoret në shkrimet ku marrëdhënia Shqipëri-Serbi lidhet me çështjen e Kosovës dhe ngjarjet në Kosovë.

### 3. Marrëdhëniet Serbi-Kosovë

Ashtu siç është rasti me marrëdhëniet Shqipëri-Serbi edhe marrëdhëniet Serbi-Kosovë janë përmirësuar shumë vitet e fundit. Dialogu i nivelit më të lartë politik në Bruksel ka çuar në disa

marrëveshje, të cilat përgjithësisht kanë të bëjnë me çështje të jetës së përditshme. Krijimi i Bashkësisë së Komunave Serbe në Kosovë, e dakordësuar në Bruksel, nuk është miratuar ende nga Kuvendi në Prishtinë. Kjo është një çështje që është kritikuar ashpër brenda Kosovës si një përpjekje serbe për të krijuar një Republika Srpska të dytë.

Që kur Aleksandar Vuçiç u bë kryeministër në vitin 2014, njohjet ndërkombëtare të Kosovës kanë ngelur në vend, por kjo është një çështje që ja vlen të shqyrtohet nëse ka qenë rrjedhojë e efikasitetit të politikës së jashtme të Serbisë apo jo. Në gjashtë muajt e fundit nuk ka ndryshuar asgjë e rëndësishme në marrëdhëniet Serbi-Kosovë. Incidenti me trenin serb të drejtuar për në Mitrovicë dhe të mbuluar me mbishkrime nacionaliste dhe arrestimi i Ramush Haradinajt në Francë bazuar mbi një urdhë arresti serb për krime të supozuara lufte, ishin më së shumti shfaqje anësore të një procesi që po vazhdon prej vitesh dhe që synon të përfundojë me një marrëveshje të gjerë mes Serbisë dhe Kosovës. Zgjedhja e Donald Trump si President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës krijoi në Serbi disa shpresa për një ndryshim në politikën amerikane në rajon. Në gjashtë muajt e fundit, veçanërisht që nga janari, dialogu në Bruksel ka ngelur në vend dhe Serbia dhe Kosova kanë qenë të shqetësuara nga çështje të brendshme si zgjedhjet kuvendore në Kosovë dhe zgjedhjet presidenciale në Serbi.


Meqë Shqipëria dhe Serbia nuk kanë një kufi të përbashkët dhe meqë Shqipëria dhe Serbia nuk kanë ndonjë çështje të pazgjidhur ndërmjet tyre, interesi i medias së shkruar shqiptare për Serbinë lidhet më së shumti me çështjen e Kosovës. Për këtë arsye, është e rëndësishme dhe interesante të analizohet se si Serbia paraqitet në këtë marrëdhënie me Kosovën në shtypin shqiptar. Më interesante se matja sasiore është matja cilësore, shqyrtimi i brendësisë së shkrimeve të lidhura me Serbinë dhe Kosovën.

Në periudhën gjashtëmujore që mbulon ky studim, pati plot çështje të lidhura me Serbinë dhe Kosovën që u paraqitën gjerësisht në median shqiptare, veçanërisht në janar.

### **Të dhëna të përgjithshme sasiore mbi mbulimin**

Raportimi i marrëdhënieve Serbi-Kosovë ishte më së shumti i përqëndruar në muajin janar, me 21 shkrime në atë muaj. Kjo shpjegohet prej disa çështjeve të rëndësishme në atë muaj si treni

Beograd-Mitrovicë, reagimet pas arrestimit të Ramush Haradinajt në Francë, muri në pjesën serbe të Mitrovicës në veriun e Kosovës dhe reagimet që këto ngjarje shkaktuan në të dy vendet.



Grafiku 15

Për muajt e tjerë raportimi ishte pothuajse i njëjlojtë, duke lëvizur nga 2 në 4 shkrime për muaj. Kjo tregon se raportimi i marrëdhënieve Serbi-Kosovë në shtypin shqiptar nuk ka një temë të vazhdueshme, por varet nga çështje të caktuara që kapin vëmendjen e gazetave për një periudhë kohe.

Gazeta *Panorama* kishte shumicën e shkrimeve për këtë çështje me 17 shkrime nga 35 gjithsej. *Shqiptarja.com* ishte e dyta me 11 shkrime. Shumica e shkrimeve të *Panorama-s* ishin botuar në janar, 11 nga 17 të tilla, të lidhura me çështjen e trenit Beograd-Mitrovicë dhe arrestimit të Haradinajt.



Grafiku 16

### Konotacioni

Ngjashëm me dy rastet e tjera të përshkruara në këtë studim, shumica e shkrimeve kanë një konotacion neutral. Por ndryshe nga rastet e tjera, ky është rasti studimor me më shumë shkrime me konotacion negative, 28%.



Grafiku 17

Gazeta *Panorama* ka botuar më shumë se gjysmën e shkrimeve me konotacion negativ. Disa prej shembujve të shkrimeve me konotacion negative ishin: “Serbët provokojnë me një tren, policia e Kosovës e ndalon”, “Presidenti serb kërcënon me një luftë të re në Kosovë”, “Vuçiq: Prishtina kishte plane ushtarake, ne duam paqen”. Studimi tregon se konotacioni negativ është reagim ndaj disa çështjeve të caktuara, nuk është një tipar i raportimit rreth marrëdhënieve Serbi-Kosovë në shtypin shqiptar. Kjo lloj gjuhe ka për qëllim të tërheqë sa më shumë lexues duke goditur tek ndjeshmëritë e tyre kombëtare për Kosovën dhe rrezikun nga Serbia.

Shkrimi i vetëm me konotacion pozitiv ishte botuar nga *Shqiptarja.com* në qershor: “Kryeministrja serbe flet për një kompromis me Kosovën”.

## 5. Referencat

Alba Cela, *Albania-Serbia relations in the eyes of the Albanian public 2015*, AIIS, Friedrich Ebert Stiftung, 2015

Blic, *Šest provokacija Edija Rame*, Online: <http://www.blic.rs/vesti/politika/sest-provokacija-edija-rame-albanski-premijer-kao-verbalni-dron/t1snfm5>

Dritan Sulçebe, *Kosovo and the Albanian Kosovo relations in the Albanian printed media 2016*, Albanian Institute for International Studies and Friedrich Ebert Stiftung, Tirana 2016.

Ipsos Marketing, *Public opinion in Serbia - Citizens' attitudes on Albania and Albanians and perception of relations Between peoples and states*, Friedrich Ebert Stiftung, European Movement in Serbia, 2015

Sashenka Lleshaj, Dritan Sulçebe, *Greece and the Albanian-Greek relations in the Albanian printed media 2014*, Albanian Institute for International Studies and Friedrich Ebert Stiftung, Tirana 2014